

Ne fokus/ Skandal me transmetimin e kampionatit

nga AlbaniaSoccer

E mërkurë, 04 Shtator 2013 15:00



Gjate gjithë verës, Kukesi dhe Skenderbeu bene historine ne Europe, por si platforma sportive Supersport po ashtu edhe stacione te tjera kombetare, nuk e vrane mendjen per te transmetuar ndeshjet qe duheshin pare. Irritimi i tifozëve arriti kulmin. Luanin jashte apo brenda, askush nuk transmetonte asgje. Ka nisur kampionati shqiptar dhe serish e njejta melodi. Ne gjashte ndeshje te luajtura kete jave u transmetuam vetem tre. Askush nuk pa Flamurtarin, Vllaznine, Skenderbeun apo dhe Kukesin. Mund te quhet skandaloze pasi tifozet ne te gjithë Shqiperine kane te drejte te shohin sidomos per ate qe kane paguar ne platforma dixhitale private.